RASSEGNA STAMPA

Gazetta Fenix
8 giugno 2013

KULTURE

FENIX
JAVORE SOCIAL-KULTURORE

FOLCO QUILICI:
Kujtimet e mia në Shqipërinë e Zogut dhe Hoxhës

FILM

INTOUCHABLES



Përplasja e dy botëve dhe qytetërimeve vjen e treguar në mënyrë aventureske nga regjisorët Olivier Nakache dhe Eric Toledano. Një film francez jo tipikisht francez, pa monologë 20-minutësh dhe personazhe që humbasin në terr duke mbajtur ballin shtrënguar mes duarve në një rebus të pacak ekzistencial. Asgjë e tillë. Takimi mes një aristokrati paralitik dhe një afrikani që duhet t'i shërbejë është detonatori i një historie njëherësh dramatike dhe humoristike, në një odise të bukur ekzistenciale që orvatet të shpalosë me një gjuhë të pastër filmike arsyet e qenies dhe rilindjen nga hiri i një jete të shkuar, tashmë pa kthim. "Të paprekshmit" është një film tejet dinamik dhe që ushtron një dorë të pamëshirshme mbi stereotipet shoqërore, duke konfirmuar disa sosh dhe duke thërrmuar të tjerë. Mbi të gjitha filmi duket se këmbëngul në mënyrë elegante por njëherësh kokëfortë mbi një nga dilemat e njerëzimit ende të pazgjidhura formalisht: Çdo të thotë të jetosh? Ndonëse kjo mbetet një pyetje pa përgjigje të prerë, "Të paprekshmit" arrin të japë plot shenja referuese, në një prodhim mjeshtëror dhe që nuk i përket një stili të caktuar kombëtar të kinemasë.

DOKUMENTAR

Secrets of The Samurai Sword (full documentary)

Samuraji është ndoshta luftëtari më i famshëm mesjetar në planet, i mbuluar kurdoherë me një vel misteri, legjende, mitesh dhe faktesh të vërteta nga historia e "luftëtarit të përsosur". Por, ai nuk do të ishte asgjë pa "shpirtin e samurajit", siç quhet shpata e tij. Katana është në fakt emri i vërtetë i shpatës legjendare, e cila shquhet për mprehtësinë, fortësinë dhe estetikën e saj unike. Ky dokumentar, i cili gjendet i plotë në YouTube dhe që zbulon misteret që qëndrojnë pas kësaj arme të hatashme, jo thjesht në një kontekst teknik por dhe në atë më të gjerë, shpirtëror. Kjo armë e hatashme, e aftë për ta ndarë viktimën në dysh, nëse përdoret nga duart e një mjeshtri ka hyrë në qarkullim që në shekullin XII dhe ka qenë arma zyrtare e klasës feudale japoneze. Katana përfaqëson një nga mjetet më të thjeshta dhe vdekjeprurëse në planet, e ndërtuar që brenda një sekonde të vetme të lërë millin ku qëndron dhe të bëjë një lëvizje të pastër në ajër duke lënë pas një kokë që fluturon. "Sekretet e shpatës së samurajit" përqendrohet në një masë të madhe edhe në zotëruesit bashkëkohorë të artit të lashtë të shpatës së samurajit, meshkujt dhe femra, si dhe në mjeshtrat ende të gjallë që i ndërtojnë këto armë fisnike në përputhje të plotë me metodat dhe frymën tradicionale.

MUZIKE

Paolo Conte Live Arena Di Verona 2005

Për ata që mendojnë se mjeshtri italian, i lindur në vitin 1937, i ka mbushur orët e punës, mund të njoftohet se albumi i tij i fundit "Nelson" është hedhur në qarkullim në vitin 2010, ndërsa Conte vazhdon të jetë aktiv në skenën muzikore edhe sot, pavarësisht moshës 76 vjeçare. Koncerti i mësipërm "live", i cili gjendet i plotë në YouTube përfaqëson një nga shfaqjet më mbresëlënëse të dinozaurit të xhazit italian, ku ky i fundit bashkë me bandën e tij, interpretojnë mjeshtërisht për mbi një orë e dyzet minuta në Arenën e Veronës në Itali. I dëgjuar pa parë videon, koncerti është i një cilësie të tillë sa mund të pandehet se bëhet fjalë për një regjistrim në studio dhe jo për një "live". Janë, në fakt, duartrokitjet e publikut ato që të bëjnë të përmendesh dhe të kuptosh që gjithçka po ndodh në një skenë koncerti dhe jo në rehatinë intime të një studioje regjistrimi. Një fakt për kompozitorin, poetin, këngëtarin dhe pianistin Paolo Conte është se në Shqipëri ai është shumë më i njohur ndër të rinjtë, përfshi gjimnazistë e studentë, se ndër më të rriturit, duke qenë se këta të fundit karakterizohen nga një formim më i dobët muzikor dhe kulturor në tërësi, krahasuar me brezat e rinj. Në fakt, ka një numër të konsiderueshëm "njerëzish të kulturës" që praktikisht, nuk e njohin fare këtë autor, kjo dhe falë trashëgimisë së dobët kulturore dhe artistike që nga koha e komunizmit.

SKENA & EKRANI

Dokumentaristi italian, ndër më të famshmit në botë, kujton eksklu-zivisht per Fenix epizodet që e lidhin me Shqipërinë dhe shqiptarët

Folco Quilici: Kujtimet e mia në Shqipërinë e Zogut dhe Hoxhës

NGA /// FABIO CAPPELLINI

Quilici, 83 vjeçar i suksesshëm, gjatë konferenc ës së tij të mbajtur në Pistoia, gjatë festivalit "Dialogje mbi njeriun" që tashmë ka arritur në edicionin e tij të katërt, mbajti skenën si një luan për thuajse dy orë, duke treguar anektoda dhe duke ilustruar ato me pamje nga dokumentarë si "28 ditë për të arritur në Polinezi", që ai vetë kishte xhiruar në vitet 50.
Sy inteligjentë dhe plot jetë, memorie e hekurt, një përkujdesje për kohërat dhe fjalët, vërtetë për t'u pasur zili.
Një orë pas konferencës, ulemi me të në hollin e një hoteli në qendrën historike të Pistoiës, për një bisedë të shpejtë, ekskluzivisht për "Fenix".

Dijmë që ju keni realizuar një shërbim për Arbëreshët, komunitetin Shqiptar në jug të Italisë, mund të na flisni për të?
Kanë kaluar disa vjet, dokumentari të cilit ju po i referoheni ishte pjesë e një serie të tillësh në zonën e Kalabrisë, Puglias dhe i Basilikatës.
Mbaj mend që më lanë shumë mbresa përgatitjet e një dasme shqiptare, për veshjet dhe mijra përkujdesje të tjera që i bëheshin nuses, deri sa çdo detaj t'i përgjigjej plotësisht traditës. E sjell në mend me shumë simpati edhe priftin që celebroi ceremoninë, një person vërtetë i këndshëm.

Keni qënë ndonjëherë në Shqipëri?
Po, madje dy herë, me një diferencë të madhe kohore nga njëra tjetra, dhe për shumë pak kohë:
E para isha fëmijë, para pushtimit fashist. Bashkë me familjen time bëmë një udhëtim me kroçerë nëpër Adriatik, dhe ndaluam në një port shqiptar, nuk mbaj mend në Vlorë apo Durrës. Gjatë kësaj ndalese të shkurtër ndodhi diçka shumë e veçantë. Mbërritën njëkohësisht në port dy anije: në njërën ishte mbreti Zog me shpurën e tij dhe në tjerën, shumë pranë më të, një bandë muzikore që duhet të shoqëronte mbërritjen e sovranit.
Në hyrjen e portit, anijet shkaktuan një sërë dallgësh, që duke goditur anijen tonë. Krijuan një zallamahi të rrezikshme, aq shumë sa u dëgjuan britma dhe me siguri ndonjë pasagjer ka humbur ekuilibrin dhe është rrëzuar, por nuk besoj jashtë anijes.
Nuk mund të siguroheshim mbi pasojat e ngjarjes, sepse në atë moment anija jonë po nisej, por mbaj mend që ndodhia më bëri shumë përshtypje.
Herën e dyte kam qënë shumë vite pas luftës, falë bashkëpunimit të qendrave turistike mes Italisë dhe Jugosllavisë. Përgatitëm një dokumentar mbi Adriatikun, duke prekur edhe Shqipërinë.

Folco Quilici (Ferrara, Itali, 9 prill 1930) është një nga dokumentaristët më të famshëm në botë. Për dokumentarët e tij kanë bashkëpunuar emra të tille si Italo Calvino, Ignazio Silone, Mario Soldati. Ka bashkëpunuar në shtypin italian dhe ndërkombëtar në revista (Life, Epoca, Panorama,) dhe gazeta (La Stampa dhe Il Corriere della Sera). Ka alternuar filmat dokumentar me aktivitetet e tij gazetareske, që dallohen për hetimet dhe shërbimet e veçanta që lidhen me mjedisin dhe qytetërimin. Ai fitoi "Çmimin italian për gazetarinë (1969) dhe "Çmimin Europian gazetar" (1990). Në vitin 1994 ai fitoi çmimin "Penda e Artë" për shërbimet e tij në Amerikën Latine. Ka fituar Ariun e Argjendtë në Festivalin e Filmit të Berlinit (1957) dhe David di Donatello (1972).



> Vetëm një krahasim shpalos vlerën e Folco Quilici, ai i një pianisti me zotërim të madh teknik: notat e dorës së majtë futen në serinë e notave të dorës së djathtë, përzierja është muzikë, poezia e librit dhe filmit së bashku
>
> Fernand Braudel, historian

Edhe pse mes shumë vështirësish (ishin vitet e diktaturës), unë dhe trupa arritëm të siguronim lejen për të vizituar rrënojat e një qyteti roman në jug të vendit të cilit nuk ia mbaj mend emrin, një vend vërtet përrallor. Gjatë filmimeve, një teknik i trupës vuri re një shkrim mbi sipërfaqen e një pusete dhe tha "Shikojeni, një pusetë fashiste!". Një ditë më pas e larguan nga Shqipëria.

Ju keni udhëtuar në një kohë kur turizmi masiv nuk kishte lindur akoma, dhe dokumentarët tuaj kanë qenë një shkollë më vete, që ka mahnitur dhe bërë të ëndërrojnë gjenerata të tëra italianësh, dhe jo vetëm. Nëse do duhej ta nisnit tani, në një epokë ku dyndje turistësh përshkojnë globin, në cilat tematika do të konsistonte puna juaj?
Shumë nga dokumentarët e mi flasin për arkeologji, dhe duhet thënë që zbulimet dhe vlerësimi i siteve arkeologjike është rritur tej mase në 40 vitet e fundit. Gjithsesi, nuk besoj se janë shteruar mundësitë për të dokumentuar përsëri mbi këtë temë.
Udhëtimet janë diçka që mbart shumë aspekte të ndryshme, kështu që e rëndësishmja është të gjesh çelësin për të shuar kuriozitetin e bashkohësëve.
Pa dyshim që do tentoja të integroja aspekte të nayrës, duke iu referuar jetës praktike dhe ekonomisë, duke u përpjekur në veçanti për të stimuluar gjeneratat e reja mbi tema që flasin për punën dhe njohjen e çështjeve sociale në vende të ndryshme, më të dobishme dhe të ndjera se ato folkloristike.
Të udhëtosh të ndihmon të rrisësh kapacitetin e të menduarit dhe të gjesh mundësinë për të patur sukses edhe në vendin tënd.

PAGINE ITALIANE

"Il viaggio" è il fil rouge che lega ogni intervento che si è svolto a Pistoia durante il festival "Dialoghi sull'uomo" ormai giunto alla sua quarta edizione. Questo evento ha avuto luogo dal 24 al 26 maggio, con conferenze e spettacoli che si sono svolti nelle piazze Del Duomo e dello Spirito Santo, Presso i Teatri Manzoni e Bolognini e in due casi anche nell'antico palazzo comunale. Tutte le conferenze hanno avuto un successo di pubblico importante, nonostante il tempo inclemente. I relatori erano tutti nomi importanti del panorama culturale italiano ed internazionale, come Franco Iseppi, presidente del Touring Club Italiano, Francesco Guccini, cantautore e scrittore, Paolo Rumiz, scrittore e giornalista di Repubblica, Toni Wheleer, viaggiatore e fondatore della Lonely planet, Arjun Appadurai, antropologo, uno dei massimi esperti al mondo sulle implicazioni culturali della globalizzazione, gli scrittori Colin Thubron e Erri De Luca, lo scrittore e cantautore Vinicio Capossela.

Pistoia Dialoghi sull'uomo
24-25-26 maggio 2013
quarta edizione

Il famoso documentarista ricorda in esclusiva per Fenix alcuni episodi che lo legano al Paese delle Aquile

Folco Quilici:

DI /// FABIO CAPPELLINI

Folco Quilici, 83 anni portati alla grande, ha tenuto come un leone il palco del piccolo Teatro Bolognini di Pistoia per quasi due ore, raccontando aneddoti e illustrando i documentari polinesiani che lui stesso aveva girato negli anni 50.
Occhi vivaci e intelligenti, una memoria di ferro, un attenzione ai tempi del palco e alle parole davvero invidiabile. "28 giorni per arrivare in Polinesia", il titolo della sua applauditissima lezione. Un ora dopo sono seduto con lui nella hall di un albergo del centro storico per una breve intervista, in esclusiva per "Fenix", dove il regista ricorda alcuni avvenimenti della sua lunga ed avventurosa vita, che lo legano con l'Albania e gli albanesi.

So che lei ha realizzato un servizio su una comunità Albanese del Sud Italia, può parlarmene ?
Sono passati molti anni, il servizio a cui si riferisce era parte di una serie su Calabria, Puglia e Basilicata. Ricordo che rimasi molto colpito dalla preparazione di un matrimonio Albanese, per gli abiti e le mille attenzioni che venivano riservate alla sposa affinché ogni dettaglio rispondesse pienamente alla tradizione, ricordo con simpatia il pope che celebrava la cerimonia, una persona veramente piacevole.

È mai stato In Albania?
Si due volte, a distanza di molti anni e per pochissimo tempo: Quando ero bambino, prima dell'occupazione fascista dell'Albania, facemmo una crociera con la mia famiglia in Adriatico sostando appunto in un porto Albanese, non ricordo se Valona o Durazzo. Durante quella sosta avvenne un fatto abbastanza particolare: arrivarono contemporaneamente in porto due battelli, in uno c'era Re Zog con tutto il seguito, nell'altro, affiancato, una banda musicale che doveva accompagnare l'arrivo del sovrano. All'ingresso in porto le due imbarcazioni provocarono una serie di onde, che colpendo le fiancate di entrambi i natanti crearono un beccheggio molto pericoloso, tanto che si sentirono urla e sicuramente qualche passeggero avrà perso l'equilibrio cadendo, anche se non credo fuori bordo. Non potemmo accertarci delle conseguenze di quella vicenda perché la nostra nave in quel momento stava ripartendo, ma ricordo che rimasi molto impressionato dall'accaduto.
Molti anni dopo la guerra, con la collaborazione tra uffici turistici di Italia e Jugoslavia con una troupe preparammo un documentario sull'Adriatico, toccando anche l'Albania. Seppure tra mille difficoltà (erano gli anni della dittatura), riuscimmo ad avere il permesso per visitare le rovine di una città romana di cui non ricordo il nome, nel sud del paese, un luogo incantevole. Durante le riprese, un tecnico della troupe notò un fascio sul coperchio di un tombino e disse "Tò, guarda, un tombino fascista". Il giorno dopo fu espulso dal paese.

Lei ha viaggiato in tempi in cui il turismo

PAGINE TALIA

Folco Quilici (Ferrara, 9 aprile 1930) è tra i maggiori documentaristi cinematografici e televisivi italiani

Il suo primo lungometraggio è stato Sesto continente del 1954, ricco di suggestive immagini subacquee dedicate ai mari australi. Seguono negli anni a venire film e lungometraggi che hanno fatto storia, tra i quali: L'ultimo paradiso, Tikoyo e il suo pescecane, Fratello mare. Ai suoi documentari hanno collaborato nomi come Italo Calvino, Ignazio Silone, Mario Soldati Successivamente collabora alla stampa italiana e internazionale (Life, Epoca, Panorama, Europeo) e con quotidiani, (La Stampa e Il Corriere della Sera). Ha alternato la documentaristica cinematografica con l'attività giornalistica, segnalandosi per le inchieste ed i servizi speciali riguardanti l'ambiente e la civiltà. Ha vinto il "Premio Italia" di giornalismo (1969) e il "Premio Giornalistico Europeo" (1990). Nel 1994 ha vinto la "Penna d'Oro" per i suoi servizi sull'America Latina. Nel 1997 gli è stato conferito il "Premio Campidoglio per la Carriera nel giornalismo culturale". Ha vinto l'Orso D'argento al Festival di Berlino (1957) e il David di Donatello (1972). L'Archivio Folco Quilici dispone inoltre di una vasta documentazione del MONDO SUBACQUEO, sia del Mediterraneo sia dei mari tropicali (MAR ROSSO, CARAIBI, OCEANIA).

I miei ricordi dell'Albania, tra Zog e il regime comunista

C'è bisogno di dire che egli è ancor più l'uomo delle immagini e da questo punto di vista, uno dei primi, dei più prestigiosi che vi siano nel mondo delle immagini che parlano, che traducono il discorso, che in esso si inseriscono con forza e vi esplodono come a piacimento, perciò un solo paragone si rivela valido per situare Folco Quilici, quello di un pianista dotato di grande padronanza tecnica: le note della mano sinistra si inseriscono nella serie delle note della mano destra, la mescolanza è la musica, la poesia avvincente di libro e film assieme

Fernand Braudel, storico

di massa non era ancora nato, i suoi servizi e documentari hanno fatto scuola incantando e facendo sognare generazioni di Italiani e non solo. Se dovesse cominciare adesso , in un epoca in cui maree di turisti attraversano il globo in ogni senso, con quali tematiche affronterebbe il suo lavoro?

Molti dei miei documentari parlano di archeologia, negli ultimi 40 anni le scoperte e la valorizzazione di siti archeologici hanno avuto un grande sviluppo, ma non credo che si sia esaurita la possibilità di documentarne di nuove, su questo c'è ancora molto da fare.

Il viaggio ha molteplici sfaccettature, quindi basta cercare la chiave di lettura più adatta alla curiosità dei contemporanei.

Indubbiamente cercherei di integrare ad aspetti naturalistici, riferimenti alla vita pratica e all'economia, in particolare cercando di stimolare le giovani generazioni su temi che riguardano il lavoro e la conoscenza di aspetti sociali dei vari paesi, più utili e sentiti di quelli folcloristici. Viaggiare può aiutare a evolvere il pensiero e a trovare possibilità di realizzazione anche nel proprio paese.

Il viaggio che vorrebbe intraprendere ?

Ce ne sono molti… Prima di partecipare a queste due ultime edizioni dei "dialoghi sull'uomo", ad esempio, non conoscevo Pistoia, una bella città che avevo solo sfiorato viaggiando su territori limitrofi, in quanto parte della mia famiglia è originaria di Lammari, tra Lucca e Pistoia.

Il viaggio … a volte basta aprire la porta di casa e guardare un po' più in là del proprio naso.